



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

Nr. _____ Prot./A.Xh

Tiranë, më ____ . ____ . 2025

B I S E D I M E P Ë R F U N D I M T A R E

“Në lidhje me çështjen Nr. (JR) 6/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Genci Mane”

Kërkues/Apelues: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga Drejtuesi i Prokurorisë **z. Altin Dumani**, si dhe nga prokurori **z. Adnan Xholi** (me autorizim).

Objekti: Bisedimet përfundimtare të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme në seancë gjyqësore, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit me Nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Genci Mane.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 dhe 8 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Data e seancës: 24.7.2025.

Përpara: GJYKATËS KUSHTETUESE

KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

TIRANË

E nderuar znj. kryesuese e Trupit Gjykses!

Të nderuar gjyqtarë, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit!

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u administruan, shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor shkaqet e ankimit, prapësimet dhe aktet e administruara në cilësinë e provës në funksion të shkaqeve të ankimit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të parashtruara në ankimin e datës 31.1.2023, si dhe parashtrimeve në seancën e datës 24.06.2025, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

1. Lidhur me pasurinë *apartament me sipërfaqe 140 m²*, ndodhur në lagjen “***”, Fier, si dhe burimet e krijimit të saj, subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse gjatë hetimit administrativ në Komision, duke pretenduar ndër të tjerave se prindërit e tij kanë patur mundësi për ti dhënë shumën prej 1.700.000 lekë të deklaruar prej tij si burim krijimi për apartamentin¹ me sipërfaqe 140 m².

1.1 Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor në Kolegj, vlerësojmë se mbeti i paprovuar mbulimi me burime të ligjshme i shumës prej 1.700.000 lekë, deklaruar dhënë subjektit nga prindërit e tij dhe si rrjedhojë edhe mbulimi me burime të ligjshme i pagesës së kështit të apartamentit me sip. 140 m² në shumën prej 1.650.000 lekë², pasi subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të ardhura të ligjshme të tjera të realizuara nga prindërit e tij përtej atyre të analizuara gjatë hetimit në Komision dhe në ankimin e datës 31.1.2023.

1.2 Sikurse është trajtuar në ankim dhe në parashtrimet e seancës së datës 24.6.2025, sa i përket mundësisë së prindërve të subjektit për të krijuar me burime të ligjshme shumën prej 1.700.000 lekë, konstatojmë se edhe pse prindërit e subjektit prej vitit 1993 përfitonin pension pleqërie, **rezulton se në vitin 2004 kanë kryer një investim që është dukshëm në një vlerë më të lartë krahasuar me të ardhurat e realizuara prej tyre deri në vitin 2004.** Si rezultat, vlerësojmë se për të analizuar mbulimin me burime të ligjshme të shumës prej 1.700.000 lekë, dhënë subjektit të rivlerësimit, duhen llogaritur të ardhurat dhe më së paku shpenzimet e jetesës së prindërve të subjektit, për periudhën mars 2004 -

¹ Bashkëlidhur parashtrimeve të depozituar në Kolegj subjekti i rivlerësimit ka depozituar dhe aktet si vijon: (i) Akt ekspertimi financiar, datë ***.06.2025, 12 fletë; (ii) Kontratë noteriale dhurimi nr. ***/***, datë **.2.2024 dhe kontratë noteriale dhurimi nr. ***/***, datë **.04.2024, 17 fletë; (iii) 10 kontrata shitblerje me palë shitëse shoqëria “***” sh.p.k., të njehsuara më aktin noterial nr. *** Rep., datë **.6.2025, gjithsej 41 fletë, dhe shkresën nr. ***/**, datë ***.05.2025 të OSSh-së.

² Kjo vlerë nuk përputhet me vlerën prej 1.750.000 lekë, të paguar me mandatarkëtimin nr. ***, datë ***.3.2013.

dhjetor 2012³. Nga aktet në dosje, rezulton se gjatë kësaj periudhe (mars 2004 - dhjetor 2012), prindërit e subjektit kanë përfituar të ardhura nga pensionet që llogariten në total në shumën rreth 3.200.000 lekë, ndërsa shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë llogariten në vlerën rreth 2.430.000 lekë.

1.3 Sa më sipër, vlerësojmë se ***prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk kanë patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë subjektit shumën 1.700.000 lekë në vitin 2013*** dhe si rezultat, subjekti dhe personi i lidhur ***nuk mbulojnë me burime të ligjshme pagesën e këstit të apartamentit në shumën prej 1.650.000 lekë, në vitin 2013.***

1.4 Në vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme kjo mungesë burimesh të ligjshme merr peshë parë edhe në raport me rrethanat faktike të dala nga aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, si vijon:

1.4.1 Gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, rezultoi e pandryshuar situata faktike se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpronar në pasuritë me nr. ***/****+**-** dhe nr. **/****⁴, deri në vitin 2024. Dhurimi i pjesës së tij takuese në favor të nënës së tij për këto dy pasuri është bërë me kontratën e dhurimit nr. *** Rep., dhe nr. *** Kol., datë **.2.2024, moment kohor që është pas ushtrimit të ankimit të datës **.1.2023.

1.4.2 Pasuritë e mësipërme rezulton të jenë rivlerësuar në vitin 2017 në vlerën prej 2.614.791 lekë (pjesa takuese e subjektit të rivlerësimit llogaritet në vlerën 653.697 lekë). Pra, subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë marrë në vitin 2013 (rreth 4 vite përpara kohës së rivlerësimit) nga prindërit e tij një vlerë disa herë më të lartë se vlera e tregut për pjesën e tij takuese, vlerë për të cilën nuk vërtetohet as mënyrën e kalimit në favor të tij.

1.4.3 **Vlera e apartamentit me sip. 140 m² të blerë nga subjekti i rivlerësimit, referuar Entit Kombëtar të Banesave, konkretisht të dhënave të tregut të lirë të apartamenteve sipas udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, llogaritet në shumën prej 8.534.610 lekë, ndërsa rezulton që subjekti deklaron si vlerë blerje për këtë pasuri, shumën 4,650,000 lekë, pra shumë më pak se vlera e tregut dhe për më tepër rezulton ta ketë patur në posedim këtë apartament kohë përpara shlyerjes së çmimit të blerjes.**

1.4.4 Bazuar në mandatarkëtimin nr. ***, datë **.3.2013, dhe vërtetimin nr. Extra Prot., datë **.6.2022, lëshuar nga shoqëria “**** ****”, rezulton se ***subjekti ka paguar këstin e parë në vlerën 1.750.000 lekë, në datën **.3.2013***, që përveç se daton pas lidhjes së

³ Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u identifikuan investime apo kursime të mundshme të prindërve të subjektit për periudhën 2004-2012.

⁴ Referuar kësaj shkrese rezulton se këto pasuri janë mbyllur dhe është hapur një pasuri e vetme me nr. ***/*** dhe subjekti i rivlerësimit më së paku deri në datën e lëshimit të kësaj shkrese rezulton bashkëpronar në këto pasuri.

kontratës së shitjes⁵ (nr. ***/**, datë ***.2.2013), **bie dhe në kundërshtim me deklarin e subjektit në DV-2009, ku është deklaruar një pagesë në vlerën prej 100.000 lekë e bërë në këtë vit. Sa më sipër vlerësojmë se shuma prej 1.750.000 lekë duhet të merret në konsideratë në analizën financiare si pagesë e kryer për apartamentin në vitin 2013**, dhe jo shuma prej 1.650.000 lekë sikurse rezulton në analizën financiare të Komisionit⁶.

1.5 Sa i përket konstatimit se me gjeneralitetet Genci Mane (pa atësi) është identifikuar një abonent me kontratë të furnizimit nr. ***, në instancën Fier, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj nga: (i) Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A., (ii) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SH.A. Drejtoria Rajonale Fier dhe nga (iii) Shoqëria e Ujësjiellës Kanalizimeve Fier Sh.A., u kërkua informacion dhe dokumentacion shtesë në funksion të shqyrtimit të çështjes.

1.5.1 Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A., dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SH.A. Drejtoria Rajonale Fier, në përgjigje të sa më sipër, ndër të tjera kanë informuar se referuar të dhënave në sistemin e faturimit, kontrata Nr. **-* me kod klienti ***, i përket abonentit Genci Mane, e hapur më datë **.10.2011, në statusin pezulluar, por nuk kanë përcjellë kopje të kontratës/ kontratave që i korrespondojnë kësaj njësie apo akte në bazë të të cilave janë lidhur këto kontrata.

1.5.2 Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier Sh.A., ndër të tjera ka informuar se nga të dhënat e disponuara në sistemin ALL-Billing, rezulton se Genci *** Mane ka kontratë me Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime SH.A., Fier me nr. **. Në aktet bashkëlidhur konstatojmë se adresa e objektit që lidhet me kontratën me nr. *** është në rrugën “** **”, pallati “****”, dhe data e hapjes së kontratës është **.4.2017. Edhe në këtë rast nuk rezulton që nga Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Fier SH.A., të jetë përcjellë kontrata e furnizimit me ujë dhe aktet e paraqitura për lidhjen e kësaj kontrate.

1.5.3 Në seancën gjyqësore të datës 14.7.2025, Kolegji vendosi t’u drejtohet dhe njëherë këtyre shoqërive, duke u kërkuar kopje të kontratave të nënshkruara nga abonentit Genci Mane nëse ekzistojnë kontrata të tilla, si dhe aktet bashkëlidhur tyre.

1.5.4 Në vijim me shkresat nr. ***/** Prot., datë **.7.2025, dhe nr. ***/** Prot., datë **.7.2025, Kolegji ka përcjellë shkresat e gjyqtarit kryesues me nr. **/**** regj., datë **.7.2025 dhe **/**** regj., datë **.7.2025. Bashkëlidhur këtyre shkresave janë përcjellë

⁵ Në këtë kontratë citohet se kësti i parë në shumën 1.750.000 lekë është paguar nga pala blerëse para nënshkrimit të kontratës.

⁶ Nga aktet në dosje rezulton se si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie është deklaruar kredia e marrë në kuadër të projektit të të pastrehëve të Bashkisë Fier, ndërkohë që vërejmë se arsyetimi i Komisionit është përqendruar në referencë të vendimit nr. 600, datë 1.9.2007, të Këshillit të Ministrave: “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”.

përgjigjet e Shoqërisë së Ujësjetllës Kanalizimeve Fier SH.A., Furnizuesit të Shërbimit Universal SH.A. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SH.A. Drejtoria Rajonale Fier, si vijon:

1.5.4.1 Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A., me shkresën nr. ***/** prot., datë **.7.2025, ka përcjellë dokumentacion lidhur me kontratën me nr. ***, që i përket abonentit Genci Mane. Pjesë e akteve të përcjella nga kjo shoqëri është edhe *vërtetim nga dokumentet hipotekorë* me nr. *** që i përket pasurisë me nr. **/***+*-**, apartamenti objekt analize.

1.5.4.2 Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A., me shkresën nr. ***/** prot., datë **.7.2025, lidhur me kërkesën për të depozituar kopje të kontratës, ndër të tjera ka informuar se nuk e disponojnë në arkivin e tyre. Gjithashtu kjo shoqëri ka informuar se konsumatorët janë të regjistruar vetëm me emër, mbiemër dhe jo me atësi dhe në bazë të kushteve rregullatore të mëparshme, konsumatorët nuk ishin të detyruar të paraqisnin të dhëna të detajuara personale apo një kopje të dokumentit zyrtar të identifikimit.

1.5.4.3 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike SH.A., Drejtoria Rajonale Fier, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.7.2025, ka informuar se në arkivin e Drejtorisë Rajonale Fier/OSSH sh.a., nuk ekziston kopje dhe akte në bazë të të cilave të jetë lidhur Kontrata e Furnizimit me Energji Elektrike me nr. ***, me abonent Genci Mane.

1.6 Në përfundim të sa më sipër, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë.

2. Lidhur me ***përdorimin e automjeteve në pronësi të të tretëve***, për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës 24.06.2025, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit edhe gjatë gjykimit në Kolegj nuk provoi të kundërtën e shkaqeve të ankimit. Në analizë të akteve në dosje, në raport me qëndrimin e subjektit, mbeti e provuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm për sa parashikon neni D, pika 1 e aneksit të Kushtetutës, dhe neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me mosdeklarimin e interesit pasuror në formën e përdorimit të automjeteve, situatë kjo që, po ashtu, afekton edhe në drejtim të vlerësimit të standardit të integritetit dhe etikës së magjistratit prokuror.

3. Lidhur me ***denoncimin e shtetasit*** *** ***, për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës **.6.2025, vlerësojmë se edhe në rastin konkret, në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe dispozitat ligjore që gjejnë

zbatim për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nenet 71 - 74 të ligjit me nr. 96/2016, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit në *procedimin penal nr. *** i vitit 2020, nuk ka ndërmarrë hetime logjike dhe efektive si dhe në respektim të urdhërimeve të lëna nga gjykata*. Gjithashtu, me mangësi vlerësohet edhe kualifikimi dhe më pas regjistrimi i procedimit penal sipas paragrafit 2, të nenit 236, të Kodit Penal, ku si elemente të anës objektive paraqiten bashkëpunimi, dhuna fizike apo përsëritja më shumë se një herë, të cilat nuk rezultojnë sipas akteve në dosje të fashikullit penal.

4. Lidhur me **denoncimin e shtetasit *** ****, për sa trajtuar gjerësisht në ankim dhe parashtrimet e seancës së datës 24.6.2025, *vlerësojmë se* edhe në rastin konkret, në analizë të akteve në dosje në raport me qëndrimin e subjektit dhe dispozitat ligjore që gjejnë zbatim për rivlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, nenet 71, 73, 74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit në *procedimin penal nr. *** i vitit 2020*, në vendimet e zgjatjes së afateve të hetimit, ***nuk ka përcaktuar llojin e veprimeve hetimore për tu kryer***, vendime të cilat, nga përmbajtja e akteve në dosjen e Komisionit, nuk rezultojnë t'u jenë njoftuar të dëmtuarit dhe të pandehurve.

5. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke përfunduar për sa më sipër, bazuar në indikatorët vlerësues, të parashikuar nga nenet 71, 73, 74 të ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, për subjektin e rivlerësimit konstatohen mangësi të tilla që nuk pajtohen me pritshmërinë se prokurori duhet të udhëhiqet nga parimi i ligjshmërisë dhe ndërmarrjes së hetimeve të shpejta dhe të plota, të gjithanshme dhe objektive, me qëllim arritjen e një përfundimi të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe prova.

5.1 Por, këto arsye vlerësojmë se mangësitë e konstatuara në këtë kriter vlerësimi duhen vlerësuar së bashku me problematikat e vërejtura në kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, të cilat të çojnë në një vlerësim të ndryshëm me atë të arritur nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

KËRKIMI I ANKIMIT

6. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të datës 31.1.2023, mbështetur dhe në arsyetimin e trajtuar më sipër, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7 të nenit F të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 66, pikës 2 të nenit 4, pikës 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- **Ndryshimin** e vendimit nr. 598, datë 13.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, **dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit, zotit Genci Mane.**

DREJTUESI I PROKURORISË

Altin DUMANI

PROKURORI I AUTORIZUAR

Adnan XHOLI